



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 60/01-21134/21
Kaçanik, 30.07.2021

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/16 Qershor 2016), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar shkresës së MAPL 020-520/4 të datës 22.07.2021 lidhur me raportin vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (numri nuk shihet mirë), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Korrik 2021, mori këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01NR.60/01-15789/21 TË DATËS 15.06.2021 -PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BANESAVE NË BANIMIN SOCIAL NË FSHATIN KAÇANIK I VJETËR

1. Me këtë Vendim, ANULOHEM Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.60/01-15789/21 i datës 15.06.2021 -për themelimin e Komisionit për ndarjen e banesave në banim social në fshatin Kaçanik i Vjetër,
2. Anulimi i Vendimit i përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet pas Njoftimit të MAPL 020-560/4 të datës 22.07.2021 lidhur me raportin e vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (numri nuk shihet qartë), për shkak se i njëjti nuk është në harmoni me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2010 - Për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale.

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë) dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 60/01-15767/21
Kaçanik, 15.06.2021

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 (d) lidhur me nenin 17(k) dhe 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të Programit Komunal Trevjeçar të Banimit 2018-2021 01 Nr. 03-500/01-18704/2018 e datës 29.06.2018, pika 22.3, të nenit 6.2 lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 60/01-15789/2021 i datës 07.06.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datë: 15 Qershor 2021, mori këtë:

VENDIM


PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BANESAVE NË BANIMIN SOCIAL NË FSHATIN KAÇANIK I VJETËR

- Me këtë vendim, formohet Komisioni për ndarjen e banesave në banim social në fshatin Kaçanik i Vjetër, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve dhe atë: 3 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtar Ekzekutivi i Komunës, dhe 1 anëtar nga Sektori joqeveritar, si vijon:
 - Kadri Krivenjeva, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - Besnik Salihu, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - Hafize Sallahi, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - Xhelal Gashi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
 - Rrustem Dema, anëtar nga sektori jo qeveritar / OVL e UÇK-së.
- Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi.
- Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, Detyrat dhe Përgjegjësitë dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e tij do të bazohet në udhëzimet administrative si: Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e kontratës së banesës me qira jo profitabile, Udhëzimi Administrativ Për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Udhëzimi Administrativ Për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit, Udhëzimi Administrativ Për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit si dhe Programin Komunal Trevjeçar të Banimit 2018-2021 01 Nr. 03-500/01-18704/2018 e datës 29.06.2018.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
- Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.
- Me këtë vendim njoftohen:** Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë) dhe Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Adinitrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Data	23.07.2021	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	60/01-21134 -1.
		Shtojcë	


Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i përgjithshëm në MPL. Datë: 22.07.2021 Nr.020-560/3
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr.01/60/01-15767/21 për themelimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i vjetër i miratuar nga KK-Kaçanik, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në MMPHI, si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Liburn Allu, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Infrastrukturës Izedin Bytyqi, Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nga:	Elorije Kika, Drejtore e Departamentit të Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Lloji i aktit:	Vendimi Nr.01-60/01-15767/21 për themelimin e Komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçaniku i Vjetër i miratuar nga KK Kaçanik.

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, kompetencës ligjore të Ministrisë të përcaktuara me Ligjet bazike dhe Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores së Qeverisë (QRK) Nr. 02/2021 për Pushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamentit Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.01-60/01-15767/21 për themelimin e Komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçaniku i Vjetër i miratuar nga KK Kaçanik.

I miratuar me datë: 15.06.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 22.06.2021

I dërguar për shqyrtim në MMPHI, me datë: 22.06.2021

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr.01-60/01-15767/21 për themelimin e Komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçaniku i Vjetër i miratuar nga KK Kaçanik.	- Në preambulën e vendimit nuk është specifikuar Ligji Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimi Administrativ Nr.22/2010 Për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim. - Vendimi nuk është në harmoni me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 Për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim sepse sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ, Komisionin për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve e përcakton Kryetari i Komunës të Kaçanikut dhe aprovohet në Kuvendin Komunal të Kaçanikut.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, i propozon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshme në lidhje me këtë vlerësim.